



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Së bashku për shkollën që duam

2017-04-22 20:14:00



Ministrja e Arsimit dhe Sportit, znj. Lindita Nikolla, në aktivitetin e zhvilluar me mësuesit në Pallatin e Kongreseve "Së bashku për shkollën që duam" i falenderoi ata për mbështetjen e dhënë dhe për punën e tyre të palodhur. Ministrja Nikolla theksoi se puna e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit matet nga gjykimi i mësuesve, nxënësve dhe prindërve.

"Ne kemi ndërruar një reformë sistematike në arsim. Asgjë nuk do të ishte e mundur pa pasionin dhe punën që ju keni bërë në çdo shkollë, në qytet apo fshat. Kurrikula e re që i jep fund të mësuarit riprodhues dhe e harmonizuar për çdo fëmijë nga 3-18 vjeç është e bazuar në kornizën europiane. Tekstet e reja përmbajnë xhunglën korruptive të teksteve defekte dhe sollën lehtësimin e nxënësve nga mbingarkesa. Reforma e gjimnazit gjithashtu përmbajti epokën e gjimnazit më të mbingarkuar në Europë. Punën e masim me rezultate, si dhe me gjykimin e mësuesve, prindërve e nxënësve. Partnerët po ashtu japin vlerësime pozitive për reformën tonë. Ndjehuni krenarë dhe bëhuni zëri i së vërtetës për gjithçka keni bërë të mundur në çdo shkollë e për çdo nxënës. Kemi bërë shumë së bashku, por kemi ende shumë për të bërë"

Ministrja e Arsimit dhe Sportit, znj. Lindita Nikolla, në fjalën e saj theksoi se në këto vite u mundësua largimi i politikës nga shkolla dhe se një vend pune tashmë mund të arrihet vetëm përmes meritës dhe transparencës. E tillë ka qënë eksperiencën e 3500 mësuesve të punësuar nga portali "Mësues për Shqipërinë", të cilëve sipas ministres Nikolla nuk u shtet dashur të tregojnë taserën e partisë:

"Kemi sot 3500 mësues të punësuar përmes portalit "Mësues për Shqipërinë. Ky është sistemi ynë transparent që ka në bazë meritën dhe jo taserën apo xhepin. Sot nuk ka më diploma të blera për mësues, por nuk ka më as kredite fiktive kualifikimi. I kthjem dinjitetin maturës duke i hequr të drejtën ministrit të vendosë sipas qejfit kufirin e kalimit".

Ministrja e Arsimit dhe Sportit, Znj. Lindita Nikolla, theksoi se pavarësisht akuzave sistemi i pranimeve në universitet ka rezultuar i suksesshëm dhe është në sinkron me ato që përdor Europa.

"Sistemi jonë i pranimeve është ai që përdor bota dhe Europa. Më lejoni t'iu përgëzoj me atë që keni bërë për informimin e çdo maturanti. Me komunikimin që kam pasur me maturantët kam kuptuar që ju keni bërë një punë të lëvdueshme. Të jemi të gjithë bashkë e të mos lëmë asnjë shteg keqinformimi dhe përdorimi të maturantëve. Ne duhet të jemi aty që të informojmë çdo maturant që të mos lejojim që ata të keqinformohen".

Ministrja e Arsimit dhe Sportit, znj. Lindita Nikolla, gjatë fjalës së saj renditi disa arritjet e reformës në arsim në këto vite si: mbyllja e 22 universiteteve të cilat prodhonin diploma pa vlerë. Kjo sipas

ministres Nikolla mund t'konsiderohet si hap i parë drejt dekriminalizimit. Gjithashtu, një tjetër arritje në sistemin arsimor konsiderohet edhe heqja e 4 mijë mësuesve të cilët ishin jashtë profilit dhe pa arsimin përkatës, duke rritur kështu nivelin e mësimdhënies.

Ministrja Nikolla foli edhe për reformën e albertekstit, e cila deri në vitin 2012, rezultoi me **1,130 tekste në përdorim**, në pjesën më të madhe të tyre me **deformime dhe probleme të rënda** shkencore, konceptuale dhe gjuhësore. Në këtë kuadër, theksoi ministrja Nikolla, me synim përmirësimin dhe garantimin e cilësisë së teksteve për nxënësit shqiptarë në sistemin e arsimit parauniversitar, u ndërmor një proces i gjatë reformativ ku në procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes u ftuan mësuesit nga i gjithë vendi. Kjo procedurë, rezultoi në heqjen e **600 titujve** të tjera nga katalogu ekzistues.